

Bisedim gjuhe mbië formë të vërtetë të partiqipit

Dihet se gjuha shqype është përgojimi i gjindes shqypëtare, pra partiqipit i shqypes duhet me u lypën në votrë e në gojë të kombit arbënorë.

Kurë të ketë ndryshim përgojimi kërkohet e vërteta e e drejta edhe zgjedhet më e mbara prej 'tyne; veç me këtë mënyrë hieket gabimi, agël kështu shuhet ndryshimi.

Ndër forma të ndodhëta ngjihen e vërtete ajo që i ngjaën motrave të shqypes ndër forma të fjalëve që ndihen me ndryshim, më e vërteta është ajo që përkrahet me persishten' se persishteja është një motër e shqy-

pes; persishteja nuk kaë dyshim n'orthografië si disa gjuhë t'jera, këjo nuk kaë ndryshime dijalektesh si grekishteja e latinishteja; këjo s'kaë fytyrë të reë e të vietrë si t'jerat; në këtë nuk ndihen prrallat filologjike e të shpifënat etimologjike, këjo sot është gjallë edhe kurr s'është çrrânjuë; këjo e kaë atë orthografië, atë gramatikë që e kaë pasë gjith monë e s'e kaë çoroditë as një herë; sot këjo e kaë më të motshmen orthografië; sot ndër motra të shqypes vetëm kësajë i ndihen bash atoë rregulla që i kaë pasë së pakti një mijë vjet më parë.

Në një gjuhë më e drejta formë e fjalës është ajo që s'kaë shtesa të pa nevojshme o pyka të pa dobiëshme, të cilat e mundoin kot shumicën e kombit.

Na t'i tregojm të tana format që po ndihen në Shqypënië me diftim të partiqipit të shkuët e t'i shoshitim me nje shoshë të rallë, edhe mbas andei diatarët e madhenj le t'i sitin me një sitë të shpeshë.

Format që po ndihen në shqypënië me diftim të partiqipit të [shkuët janë këtoë:

1. kam o jam (lamën, blemën, grimën, shkramën, lymën).
2. " " (lamë, blemë, grimë, shkrumë, lymë).
3. " " (laën, bleën, grisen, shkruën, lyën).
4. " " (larë, blerë, grirë, shkruar, lyer).
5. " " (laë, bleë, grië shkruë, lyë).
6. " " (lae blee, grië, shkruë, lye).
7. " " lamun, blemun, grimun, shkrumun, lymun).
8. " " (falën, gjetën, fikën, lutën, korrën, mbyllën).
9. " " (falun, gjetun, fikun, lutun, korrun, mbyllun).
10. " " falur, gjetur, fikur, lutur, korrur, mbyllur.
11. " " (falë, gjetë, fikë, lutë; korrë, mbyllë).
12. " " (laitën, bleitën, griitën, shkruitën, lyitën).
13. " " (laitë, bleitë, griitë, shkruite, lyitë).
14. " " (laitun, bleitun, griitun, shkruitun, lyitun).

Kështu, kuptohet se prapashtesat e partiqipit po ndihen edhe krejt si t'infinitit.

Prë mbassi prapashtesa e vertetë e infinitit ishte *ën*, e kurë prapashtesa e partiqipit kjënka krejt si e infinitit, çeltazi hetohet se forma e vertetë e partiqipit është ajo që përgojet me prapashtesën *ën*, sikurë: kam *falën*, kam *laën* e kam *lamën*.

Prapashtesa *ën* në gjermanishte është gjithmonë e infinitit e shum here e partiqipit.

Shum kù e mjaft herë mbarimi i partiqipit dallohet prej t'infinitit vetem me mëngim të shkrollës *n*, sikurë: me *falën*, kam *falë*; me *lamën* kam *laë*, kejo rrëgull kështu është edhe në persishtë.

Forma e partiqipit që ndihet si në persishtë është e vertetë po [si ajo që i gjaënte gjermanishtes, se si persishteja ashtu edhe gjermanishteja janë dyë motra të shqypes me gramatika të mbaruëna.

Por nga shkaqet e nënshkruëne meret vesh se për shqypen forma e partiqipit që përkrahet me persishten është më e drejtë se ç'do formë t'jetrë.

a) Prapashtesa *ën* në partiqipa të gjermanishtes nuk është rregullisht per ç'do tfillk, si në shqype.

b) Në gjuhën shqype *n* ja e fundit të partiqipit të shkuët është një tepricë e pa as një dobië.

c) Përgojësit e partiqipit të pa *n*, janë katr'a pësë here më shum se t'atië që asht me 'të.

ç) Forma e partiqipit të pa *n* e kaë një dobië që dallohet me prapashtesë nga forma e vertete e infinitit.

d) Kù do që flitet forma e partiqipit me *n*, ndihet më shpesh edhe trajta e pa të; por kù do që flitet trajta e pa *n*, nuk ndihet forma me 'të, prandej kuptohet se forma me *n* po përgojët fort rrallë e prej pak kujë. Format t'jera shihen që janë të shpifëna prej ketynë të dyë formave që u treguen për të vërteta.

Nga shkaqet e nënshkruëna mundet me u thënë së: forma e infinitit me *falë*, me *laë*, me *gjetë*, është shum më e drejtë se ajo që mbaron me *n*, si: me *falën*, me *laën* o me *lamën*, me *gjetën*.

a) Si në një dijalekt të shqypes ashtu edhe në persishte, në gjermanishte e në grekishte infiniti po mbaron me *n*, por mos të karroim se në këtoë gjuhë, vetëm kurë t'jetë këjo *n* fjalës i kuptohet diftimi infinituër prandej *n* ja është e nevojëshme. Në shqypen diftimi infinituër fjalës, meret vesh vetëm tuj kjënë para grimca, me prandej *n* ja e fundit është krejt e kotë.

b) Përgojuësit e formës s'infinitit të pa *n* janë 70 e të formës me *n* munden me kjënë n'ja 30 per qint të kombit shqypëtarë:

c) Kù do që flitet forma e infinitit me *n* ndihet më shpesh edhe trajta e pa 'të, por ku do që flitet trajta e pa *n*, nuk po ndihet forma me 'të prandej kuptohet se *n* ja e fundit t'infinitit është një shtesë e pa nevojëshme se nuk e kaë as një detyrë; këjo *n* është një pyk fort e dëmshme se e mundon e shumicën e kombit krejt kot.

Bisedim gjuhe mbië formë të vërtetë të partiqipit

Dihet se gjuha shqype është përgojimi i gjindes shqypëtare, pra partiqipi i shqypes duhet me u lypën në votrë e në gojë të kombit arbënorë.

Kurë të ketë ndryshim përgojimi kërkohet e vërteta e e drejta edhe zgjedhet më e mbara prej 'tyne; veç me këtë mënyrë hieket gabimi, agël kështu shuhet ndryshimi.

Ndër forma të ndodhëta ngjihet e vërtetë ajo që i ngjaën motrave të shqypes ndër forma të fjalëvet që ndihen me ndryshim, më e vërteta është ajo që përkrahet me persishten se persishteja është një motër e shqypes; persishteja nuk kaë dyshim n'orthografië si disa gjuhë t'jera, këjo nuk kaë ndryshime dijalektesh si grekishteja e latinishteja; këjo s'kaë fytyrë të reë e të vietrë si t'jerat: në këtë nuk ndihen prrallat filologjike e të shpifënat etimologjike, këjo sot është gjallë edhe kurr s'është çrrânjuë; këjo e kaë atë orthografië, atë gramatikë që e kaë pasë gjith monë e s'e kaë çoroditë as një herë; sot këjo e kaë më të motshmen orthografië; sot ndër motra të shqypes vetëm kësajë i ndihen bash atoë rregulla që i kaë pasë së pakti një mijë vjet më parë.

Në një gjuhë më e drejta formë e fjalës është ajo që s'kaë shtesa të pa nevojshme o pyka të pa dobiëshme, të cilat e mundoin kot shumicën e kombit.

Na t'i tregojm të tana format që po ndihen në Shqypënië me diftim të partiqipit të shkuët e t'i shoshitim me një shoshë të rallë, edhe mbas andei dietarët e madhenj le t'i sitin me një sitë të shpeshë.

Format që po ndihen në Shqypënië me diftim të partiqipit të shkuët janë këtoë:

Por nga shkaqet e nenshkruënë meret vesh se për shqypen forma e partiqipit që pëkrahet me persishten është më e drejtë se ç'do formë t'jetrë.

a) Prapashtesa *ën* në partiqipa të gjermanishtes nuk është rregullisht për ç'do fillk, si në shqype.

b) Në gjuhën shqype *n* ja e fundit të partiqipit të shkuët është një tepricë e pa as një dobië.

c) Përgojësit e partiqipit të pa *n*, janë katr'a pesë herë më shumë se t'atitë që asht me t'ë.

ç) Forma e partiqipit të pa *n* e kaë një dobië që dallohet me prapashtësë nga forma e vertetë e infinitit.

d) Kù do që flitet forma e partiqipit me *n*, ndihët më shpesh edhe trajta e pa t'ë; por kù do që flitet trajta e pa *n*, nuk ndihet forma me t'ë, prandej kuptohet se forma me *n* po pëgojë fort rrallë e prej pak kujë. Format t'jera shihen që janë të shpifëna prej këtyne të dyë formavet që u treguen për të verteta.

Nga shkaqet e nënshkruëna mundet me u thanën se: forma e infinitit *me falë, me laë, me gjetë*, është shumë më e drejtë se ajo që mbaron me *n*, si: *me falën, me laën o me lamën, me gjetën*.

a) Si në një dijalekt të shqypes ashtu edhe në persishte, në gjermanishte e në grekishte infiniti po mbaron me *n*, por mos të harroim se në këtoë gjuhë, vetëm kurë t'jetë këjo *n* fjalës i kuptohet diftimi infinituër prandej *n* ja është e nevojëshme. Në shqypen diftimi infinituër [i] fjalës, meret vesh vetëm tuj kjenë pora grimca, *me* prandej *n* ja e fundit është krejt e kotë.

b) Përgojuësit e formes s'infinitit të pa *n* janë 70 e të formës me *n* munden me kjenë një a 30 për qint të kombit shqypëtarë:

c) Kù do që flitet forma e infinitit me *n* ndihet më shpesh edhe trajta

1	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(lamën,	blemën,	grimën,	shkrumën,	lymën).
2	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(lamë,	blemë,	grimë,	shkrumë,	lymë).
3	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(laën,	bleën,	griën,	shkruën,	lyën).
4	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(larë	blerë,	grirë,	shkruar,	lyer).
5	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(laë	bleë,	grië,	shkruë,	lyë).
6	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(lae	blee,	grie,	shkrue,	lye).
7	<i>kam</i>	<i>jam</i>		lamun,	blemun,	grimun,	shkrumun,	lymun).
8	<i>kam</i>	<i>jam</i>	(falën,	gjetën,	fikën,	lutën	korrën,	mbyllën).
9	<i>kam</i>	<i>jam</i>	(falun,	gjetun,	fikun,	lutun,	korrun,	mbyllun).
10	<i>kam</i>	<i>jam</i>	(falur,	gjetur,	fikur,	lutur,	korrur,	mbyllur.
11	<i>kam</i>	<i>jam</i>	(falë,	gjetë,	fikë,	lutë,	korrë,	mbyllë).
12	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(laitën,	bleitën,	griitën,	shkruitën,	lyitën).
13	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(laitë,	bleitë,	griitë,	shkruitë,	lyitë).
14	<i>kam</i>	<i>jam</i>		(laitun,	bleitun,	griitun,	shkruitun,	lyitun).

Kështu, kuptohet se prapashtesat e partiqipit po ndihen edhe krejt si t'infiniteit.

Prá mbassi prapashtesa e vërtetë e infiniteit ishte *ën*, kurë prapeshtesa e partiqipit kjënka krejt si e infiniteit, çeltazi hetohet se forma e vërtetë e partiqipit është ajo që përgojet me prapashtesën *ën*, sikurë: *kam falën*, *kam laën* e *kam lamën*.

Prapashtesa *ën* në gjermanishte është gjithmonë e infiniteit e shumë herë e partiqipit.

Shum kù e mjaft herë mbarimi i partiqipit dallohet prej t'infiniteit vetëm me mângim të shkrolës *n*, sikurë: me *falën*, *kam falë*; me *lamën* *kam laë*, këjo rregull kështu është edhe në persishtë.

Forma e partiqipit që ndihet si në persishtë është e vërtetë po si ajo që i gjaënte gjermanishtes, se si persishteja është edhe gjermanishteja janë dyë motra të shqypes me gramatika të mbaruëna.

e pa 'të, por ku do që flitet trajta e pa n , nuk po ndihet forma me 'të prandej kuptohet se n ja e fundit t'infinitit është një shtesë e pa nevojëshme se nuk e kaë as një detyrë; këjo n është një pyk fort e dâmshme se e mundon shumicën e kombit krejt kot.

S(alih) Gjuka.



Salih Gjuka, autori i këtij artikulli për pjesoren e shqipes (botu me 1913), më habiti për të mirë me analizën e hollë që ia ka ba pjesores së shqipes. Megjithëse asht një artikull i shkurtë, ka një trajtim të thellë dhe gjithëpërfshimës të çashtjes me të cilën merret. Kjo tregon se autori ka ba një punë shumë të madhe parapërgatitore, por i asht dashë me i shprehë mendimet e tij në një artikull të shkurtë gazete.

Sali Gjuka, i lindun në Pejë dhe i shkolluem në Shkup, u ba pjesë e lëvizjes kombtare për pavarësinë e Shqipnisë. Asht një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë me 1912 dhe anëtar i senatit. Ma vonë ishte ndihmës i Luigj Gurakuqit, në kohën kur ky ishte ministër i Arsimit. Me 1913 nisi punë si drejtor i arsimit i Qarkut të Beratit, ku hapi shkollën e përkohshme normale. Ishte një nga organizatorët e Kongresit të Lushnjës dhe përkrahës i Revolucionit të Qershorit, 1924.

Vdiq nga tuberkulozi me 1925 në Berat.

Përgatiti për botim A.M.